



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 823/4 Prot.

Tiranë, më 21.04 2026

VENDIM

Nr. 59 datë 21.04 2026

PËR

**NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE FEDERATËS SHQIPTARE TË VOLEJBOLLIT**

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin të Rektoratit nr. 63 datë 15/04/2026**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **21/04/2026**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Federatës Shqiptare të Volejbollit**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____, 2026

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____, 2026

DRAFT MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje lidhet ndërmjet palëve:

Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST) përfaqësuar nga Rektori

Prof. Dr. Agron KASA

Adresa : Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë-Shqipëri

Tel/Fax: +355 (04) 2226652

Website: www.ust.edu.al

E-mail: contact@ust.edu.al

Federata Shqiptare e Volejbollit, përfaqësuar nga Presidenti **Z. Erlind Pëllumbi**

Adresa:1001, Tiranë – Shqipëri

Tel:

Web :

Email

Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Federata Shqiptare e Volejbollit, këtu e në vijim të referuara si *Palë*:

Duke qënë se Universiteti i Sporteve të Tiranës është i vetmi institucion i lartë i këtij lloji ne Republikën e Shqipërisë në funksion të përgatitjes të mësuesve të edukimit fizik dhe specialistëve të të gjitha sporteve.

Duke qënë se Federata Shqiptare e Volejbollit është autoriteti më i lartë i futbollit në Shqipëri, përgjegjës dhe kompetent, për organizimin e sportit të volejbollit në vend si dhe për Ekipe të kombëtare të volejbollit; Roli i Federatës sportive përcakton qartë edhe kualifikimin e formimit të trinerëve.

Duke pranuar se studentët e Universitetit i Sporteve të Tiranës kanë nevojë për kualifikime dhe aktivitete specifike lidhur me veprimtarinë sportive garuese, si dhe duke pranuar se Federata Shqiptare e Volejbollit është në kërkim të burimeve njerëzore me potencial për t'i zhvilluar si strajnerë të kualifikuar të përgatitjes fizike për të marrë pjesë në kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje është bashëpunimi i palëve në aktivitetet sportive dhe veprimtarite, trajnuese e kualifikuese, në veçanti për formimin e trajnerëve të pregtitjes fizike, të organizuara nga FSHV dhe UST duke kontribuar me të gjithë kapacitetin infrastrukturor, bazën materiale dhe burimet njerëzore të disponueshme.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi mes dy subjekteve për nxjerrjen sportistëve, trajnerëve dhe specialistëve të një kualifikimi të lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sportit, volejbollit, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje është mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndyshuar.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- 4.1 Palët për çdo aktivitet, verimtari, apo projekt hartojnë një marrëveshje specifike të detajuar.
- 4.2 UST do të verë në dispozicion të FSHV, të gjithë kapacitetin infrastrukturor dhe bazën materiale për nevoja të organizimit të kualifikimeve dhe trajtimeve.
- 4.3 UST angazhohet të ftoj përfaqësues të Federatës Shqiptare të Volejbollit në aktivitetet akademike, shkencore, kulturore dhe sportive, si dhe konferencat e organizuara.
- 4.4 FSHV do të bashkëpunojë me stafin akademik në trajnime dhe kualifikime të ndryshme, në përmirësim e cilësisë të trajnerëve.
- 4.5 FSHV në bazë të propozimeve të UST-së organizon praktika profesionale për studentet e universitetit.
- 4.6 Pasqyrimi i të dhënave të federatës si dhe të mundësive të punësimit / trajnimit në portalin e Qendrës së Karrierës së UST-së.
- 4.7 FSHV do të verë paraprakisht në dispozicion të Universitetit kalendarin e eventeve sportive dhe vendin ku do të organizohen si dhe do t’i japë akses stafit të Universitetit në ambientet ku do të organizohen eventet sportive.
- 4.8 Organizimi i programeve të studimit të përbashkëta sipas nevoja dhe studimit të tregut.
- 4.9 Testimi dhe kontrolli fizik periodik i ekipeve kombëtare pranë laboratoreve të UST-së.

Neni 5

Njoftimet

- 5.1 Njoftimet që lidhen me detyrimet e paleve për zbatimin e kësaj marrëveshje, bëhen sipas rastit me gojë dhe me shkrim.

5.2 Palët marrin përsipër të njoftojnë njëra - tjetrën menjëherë për ndryshime të papritura lidhur detyrimet respektive.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e lindur ndërrnjët paleve, në lidhje me zbatimin e kushteve të kesaj marreveshje, do të paraprihet nga diskutimet për zgjidhjen me mirëkuptim të tyre, ne të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Autoriteti dhe afati i zbatimit

Autoritetin për të zbatuar këtë marrëveshje e ka **Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Federata Shqiptare e Volejbollit**. Kjo marrëveshje është për një afat të papërcaktuar.

Neni 8

Mirëkuptimi dhe vullneti për bashkëpunim

1. **Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Federata Shqiptare e Volejbollit** shprehin mirëkuptimin dhe vullnetin për një bashkëpunim të frytshëm dhe rezultativ.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse të **Universitetit dhe Federatës** për hartimin e planeve të përbashkëta për realizimin e angazhimeve të palëve.

Neni 9

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje e lidhur midis **Universitetit i Sporteve të Tiranës dhe Federatës Shqiptare të Volejbollit** mbahet në 2 (dy) kopje origjinale dhe ka fuqi zbatuese nga punonjësit e tyre.

Marrëveshja përbëhet nga tre fletë dhe secila prej tyre nënshkruhet nga titullarët e institucioneve.

Vendi dhe data e nënshkrimit

Tiranë më: ___ / ___ / 2026

PËR

**UNIVERSITETIN E SPORTEVE
TË TIRANËS**

**REKTORI
Prof.Dr. Agron KASA**

PËR

**FEDERATËN SHQIPTARE
TË VOLEJBOLLIT**

**PRESIDENT
Z. Erlin PËLLUMBI**